



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministarke Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 106 /2021

Datë: 02 / 07 2021

Në mbështetje të nenit 10, (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (GZ, nr. 7/01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8, (paragrafi 1, nënparagrafi 1.4) të Rregullores (QRK) - NR. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive (30.03.2021), si dhe nenit 24/B (paragrafi 4) të Rregullores QRK-NR. 12/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores QRK-NR. 31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, Ministria e Drejtësisë, nxjerr:

V E N D I M

1. Znj. Brikena Rrahmani emërohet Zyrtare në Divizionin për Koordinimin e Procesit për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara.
2. Ë emëruara nga pika 1 e këtij Vendimi ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e saj në pajtim me dispozitat përkatëse të Rregullores QRK-NR. 12/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores QRK-NR. 31/2013 për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë si dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Mandati i të emëruarës në pikën 1 të këtij Vendimi fillon me datë 05.07.2021 dhe zgjatë deri me datë 20.04.2023.
4. Të ardhurat personale të të emëruarës nga pika 1 e këtij Vendimi do të paguhen në vlerën e caktuar me vendimin nr. 78/2021 të datës 28.04.2021.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


A R S Y E T I M

Me qëllim të zbatimit të obligimeve të përcaktuara me Ligjin nr. 05/L-054 për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencial në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, dhe akteve nënligjore për zbatimin e tij, me Rregulloren QRK-NR. 12/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores QRK-NR. 31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, (tutje: Rregullorja), është themeluar Divizionin për Koordinimin e Procesit për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara (më tej: Divizioni).

Neni 24/B i Rregullores, përcakton përgjegjësitë e Divizionit, numrin e të punësuarve, si dhe të drejtën e Ministrit të Drejtësisë për emërimin e zyrtarëve në këtë Divizion për periudhë të caktuar.

Duke qenë se numri i të punësuarve në Divizion nuk është i kompletuar, dhe me qëllim të kryerjes së detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

për: **Albulena Haxhiu**



Ministre e Drejtësisë



Vendimi i'u dërgohet:

- Të emëruarës Znj. Brikena Rrahmani;
- Kabinetit të Ministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;
- Divizionit për Burime Njerëzore;
- Divizionit për Buxhet dhe Financa;
- Divizionit për Koordinimin e Procesit për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara dhe
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.